



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.294/7 prot.

Datë 23.02.2026

V E N D I M
Nr.296/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-68523-11-12-2025, me objekt: “Loti 9 “Furnizim vendosje Grafi DR”, me fond limit 7,033,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Ankimues: “KONEX” SHPK me NIPT L71417022J dhe adresë: Rr. Jordan Misja, Kati 2, Njesia 1, Z.k 8830, Njesia Bashkiake nr 9, Tirane

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Subjekte të Interesuara:

“Bora Group Albania” SHPK me NIPT L71819028K dhe adresë: *Njësia Bashkiake nr.7, Rruga Babë Rexha, pallatet EDILAL, Dyqani nr.1, Tiranë*

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesat pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.12.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-68523-11-12-2025, me objekt: “Loti 9 “Furnizim vendosje Grafi DR”, me fond limit 7,033,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2 Në datën 27.01.2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 14.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “BORA GROUP ALBANIA” shpk	vlerë	4,459,000 lekë	kualifikuar
2. OE “KONEX” shpk	vlerë	4,620,000 lekë	kualifikuar
3. OE “Medical C. Albania” shpk	vlerë	4,690,000 lekë	kualifikuar
4. OE “Albadent Group” shpk	vlerë	5,666,007 lekë	kualifikuar
5. OE “MONTAL” shpk	vlerë	5,980,000 lekë	kualifikuar
6. OE “Health & Light” shpk	vlerë	6,400,00 lekë	skualifikuar
7. OE “BIOMETRIC ALBANIA” shpk	vlerë	6,770,000 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 20.01.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 29.01.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6293, si dhe nr. 294/2026 prot., datë 30.01.2026, i operatorit ekonomik “KONEX” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-68523-11-12-2025, me objekt: “Loti 9 “Furnizim vendosje Grafi DR”, me fond limit 7,033,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën

e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 294/1 date 30.01.2026, lidhur me kriteret kualifikuese për të cilat pretendohet se nuk përmbushen nga ana e operatorit ekonomik “Bora Group Albania” SHPK konkretisht duke pretenduar:

“

Ne pretendojmë se ofertuesi, operatori ekonomik “BORA GROUP ALBANIA” është kualifikuar në mënyrë të padrejtë pasi nuk i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara nga vetë AK në dokumentet standarte të tenderit.

- Së pari në dokumentet standarte të tenderit në pikën 2.3.6 kërkohet: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje

Në lidhje me sa më lart nga të dhënat që kemi në lidhje me shoqërinë “Bora Group Albania” Sh.p.k. dhe produkti që ka ofertuar nuk plotëson Kërkesa e Veçanta për Kualifikim sipas pikës 6 Seksioni 2.3 Kapaciteti Teknik pasi për njësitë përbërëse të Grafi DR dhe konkretisht :

-Nuk disponon Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për Tubi i rrezeve X si dhe pjesën përbërëse të tubit Matja e dozës së rezatimit(DAP-meter) i cili nuk prodhohet nga kompania ofertuar

-Nuk disponon Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për Dedektori, Detektor Dixhital Flat Panel ëiFi I levizeshme,

-Nuk disponon Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për pjesën përbërëse të Shtrati I grafise konkretisht paisjen Gridës së ndërrueshme si dhe për paisjen që ben Kontroll automatic i ekspozimit,minimum tre fusha(AEC)"

Sa më sipër oferta e ofertuesit Bora Group Albania duhet të mos merret parasysh.

- Gjithashtu pretendojmë se ofertuesi, operatori ekonomik “BORA GROUP ALBANIA” është kualifikuar në mënyrë të padrejtë pasi nuk ka përmbushur të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara nga vetë AK në dokumentet standarte të tenderit.

Nga të dhënat që kemi në lidhje me shoqërinë “Bora Group Albania” Sh.p.k. përsa i përket paisjes Grafi Dr, me të cilën shoqëria Bora Group Albania ka ofertuar , nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara në DST si vijon;

-Në lidhje me specifikimet teknike /Kërkesat e gjeneratorit :

Kriteri : Vet diagnostikim I gjeneratorit me mesazhe gabimi në rastë defekti nuk plotësohet nga paisja e ofertuar, mosplotësimi i këtij kriteri sjell kosto shtese në të ardhmen për spitalin.

-Në lidhje me specifikimet teknike /Kërkesat Tubit me reze x:

Kriteri : Matja e dozës së rezatimit(DAP-meter) dhe paraqitja e vlerave të matura në konsolën e operatorit , nuk përmbushet pasi paisja e ofertuar nuk paraqet vlerat e matura tek konsola e operatorit.

-Në lidhje me specifikimet teknike /Kërkesat e Kolonës së Tubit

Kriteri : Funksion automatic i centrim të poterit me tubin nuk përmbushet nga paisja e ofertuar

si pasoje kryerja e procesit në mënyrë manuale sjell vonesa gjate ekzaminive te urgjences.

-Në lidhje me specifikimet teknike /Kërkesat e shtratit te grafise :

Kriteri : Karikues i integruar i detektorit ne poter nuk plotësohet nga paisja e ofertuar.

Kriteri : Ndjekja e levizjes horizontale te tubit nga detektori ne tavoline nuk plotësohet nga paisja e ofertuar si pasoje kryerja e procesit në mënyrë manuale sjell vonesa gjate ekzaminive te urgjences

-Në lidhje me specifikimet teknike /Kërkesat e stativit vertikal

Kriteri : Diapazoni i levizjes vertikale: ≥ 150 cm nuk plotësohet nga paisja e ofertuar ku Diapazoni i levizjes vertikale është < 139 cm

-Në lidhje me specifikimet teknike /Kërkesat e konsolës se operatorit

Kriteri : Parametrat kompjuterike minimum 16 GB Ram, HDD minimum 1 TB, nuk plotësohen pasi parametrat e kompjuterike të paisjes së ofertuar janë 8 GB Ram gje qe con ne ngadalsimin e perpunimit te imazhit dhe rrit kohen e ekzaminimit.

Kriteri : Periresim i bordurave dhe reduktim i zhurmave nuk plotësohet.

Në lidhje me sa më lart, përmbushja e plotë dhe e pakushtëzuar e kriterëve dhe specifikimeve teknike për pajisjet mjekësore përbën një kriter të panegociueshëm, pasi këto kërkesa lidhen drejtpërdrejt me sigurinë e pacientëve, funksionimin korrekt të pajisjeve

Gjithashtu theksojmë që paisja Grafi Dr me të cilën shoqëria Bora Group Albania operon, ka vlerë më të ulët sesa paisja Grafi Dr që përmbush specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Për sa më sipër gjykojmë se ofertuesi “BORA GROUP ALBANIA” duhet të skualifikohet dhe oferta e tij të mos meret parasysh

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Veprimet e mësipërme të kryera nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duke renditur si ofertues të parë kompaninë e mesiperme pavarësisht këtyre mangësive që ne pretendojmë se egzistojnë bie në kundërshtim me Nenin 2 i ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, “Qëllimi i ligjit” parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është:.....d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”*, nenin 3 “Parime të përgjithshme” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave” ku citon se “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit” si dhe VKM-në nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar neni 82 “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.*

Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, në zbatim dhe përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Vendimin nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kërkojmë nga ana Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik të vendosë:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga shoqëria “Konex” shpk,
2. Të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertuesit “BORA GROUP ALBANIA” dhe kualifikimin në vend të parë të ofertës së dhënë nga ana e kompanisë tonë në procedurën e prokurimit “Procedura e hapur ndërkombetare - mallra”, zhvilluar në datë 15.12.2025 nga Autoriteti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, me objekt: *Loti 9 “Furnizim Vendorsje Grafi DR”* me fond limit 7 033 333 (shtatë milion e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH , me numer reference REF-68523-11-12-2025

II.7. Me datë 04.02.2026 operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike formularin e argumentave në kuptim të nenit 113 të *lex specialis* i cili u protokollua me tonën me nr.294/2 prot., datë 04.02.2026.

II.8. Me shkresën me nr. 457/11 prot., datë 10.02.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga “Biometric Albania” SHPK lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-68523-11-12-2025 me objekt “Loti 9 Furnizim vendorsje Grafi DR” protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 294/3 prot., datë 10.02.2026 autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara ka dorëzuar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike vendimin e KSHA për shqyrtimin e ankesës me nr. 20/2026 datë 10.02.2026 ku rezulton se ka refuzuar ankesën duke argumentuar:

“

II.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit, KSHA

ARSYETON:

II.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “KONEX” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “BORA GROUP ALBANIA” shpk me arsyen se: *nuk janë paraqitur autorizime prodhuesish*, KSHA arsyeton se:

Në dokumentete e tenderit, kapaciteti teknik, pika 6 është përcaktuar se:

“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin /distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”

Referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, datë 12.11.2025, argumentohet:

Argumentimi: Ky kriter është i përcaktuar në Ligj nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në zbatim të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, përsa i përket kërkesës për Autorizim për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, garanton furnizime të qendrueshme me gamën e artikujve, të cilët janë tejet specifike për nga natyra dhe kanë nevojë për siguri në zinxhirin e furnizimit. Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore,” i ndryshuar, i cili përcakton kërkesat kryesore për vendosjen në treg të pajisjeve mjekësore, procesin e regjistrimit, vlerësimit e konformitetit (sipas klasës së riskut të cilës u përket), mënyrën e shpërndarjes, inspektimin dhe mbikëqyrjen e këtyre pajisjeve. Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Datë 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”.

Në Nenin 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane

Në nenin 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar:

"Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a)

mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “BORA GROUP ALBANIA” shpk, konstaton paraqitjen e katalogëve teknikë përkatës si dhe autorizimet e prodhuesve për të gjithë artikujt e cituar në Shtojcën 6 të specifikimeve teknike për këtë lot.

Së pari, Komisioni i shqyrtimit të Ankesave citon se: katalogët teknikë janë dokumente teknike të lëshuara nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, të cilat përshkruajnë në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike, funksionale dhe cilësore të artikujve të ofertuar, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Autorizimet e prodhuesit janë dokumente zyrtare të lëshuara nga prodhuesit përkatës, të cilat vërtetojnë se operatori ekonomik është i autorizuar për tregtimin, shpërndarjen ose furnizimin e artikujve objekt prokurimi, duke garantuar origjinalitetin dhe burimin e ligjshëm të tyre. Ndërsa specifikimet teknike janë produktet dhe pajisjet e detajuara në Shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit, për të cilat janë përcaktuar kërkesa të qarta teknike dhe funksionale, të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Analiza krahasuese ndërmjet kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike dhe të dhënave të përfshira në katalogët teknikë përkatës tregon se artikujt e ofertuar përmbushin plotësisht kriteret teknike të kërkuara, si për sa i përket parametrave funksionalë, ashtu edhe standardeve të cilësisë, dimensioneve, materialeve përbërëse dhe performancës së deklaruar. Informacioni i paraqitur në katalogë është i mjaftueshëm, i verifikueshëm dhe i përputhshëm me kërkesat e dokumenteve të tenderit, duke mundësuar një vlerësim të qartë dhe të paanshëm të ofertës teknike.

Njëkohësisht, operatori ekonomik “BORA GROUP ALBANIA” shpk ka paraqitur autorizimet përkatëse të prodhuesve për të gjithë artikujt e ofertuar, të cilat vërtetojnë në mënyrë të qartë se ai është i autorizuar për furnizimin dhe tregtimin e këtyre produkteve. Këto autorizime garantojnë origjinalitetin e artikujve, burimin e ligjshëm të tyre, si dhe përputhshmërinë me standardet dhe specifikimet e përcaktuara nga vetë prodhuesit.

Në këtë kuadër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë dhe e argumentuar ndërmjet kërkesave të specifikimeve teknike, të dhënave të

Konkretisht, lidhur me artikujt/produktet e kontestuara nga ankimuesi, përkatësisht:

- *Tubi i rrezeve X, si dhe pjesa përbërëse e tij për matjen e dozës së rrezatimit (DAP-meter);*
- *Detektori, përkatësisht detektori dixhital Flat Panel Ëi-Fi i lëvizshëm;*
- *Shtrati i grafisë, konkretisht pajisja Grid e ndërrueshme;*
- *si dhe pajisja për kontroll automatik të ekspozimit (AEC), minimum tre fusha,*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren se, për këto produkte, si dhe për një sërë artikujsh të tjerë të përfshirë në ofertë, operatori ekonomik “BORA GROUP ALBANIA” sh.p.k ka paraqitur katalogët teknikë përkatës të lëshuara nga prodhuesi “DRGEM, Your Best Healthcare”, të cilët përmbajnë përshkrime të detajuara të karakteristikave teknike, funksionale dhe performuese të secilit komponent të ofertuar.

Nga shqyrtimi i këtyre katalogëve teknikë rezulton se parametrat e deklaruar për tubin e rrezeve X, sistemin e matjes së dozës së rrezatimit (DAP-meter), detektorin dixhital Flat Panel Ëi-Fi të lëvizshëm, si dhe për sistemet përbërëse të shtratit të grafisë, përfshirë Grid-in e ndërrueshëm dhe pajisjen për kontroll automatik të ekspozimit (AEC), janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 6 të specifikimeve teknike për lotin objekt shqyrtimi.

Paralelisht me katalogët teknikë, për këto produkte është paraqitur edhe autorizimi i prodhuesit, me datë 11.11.2025, i lëshuar nga prodhuesi “DRGEM, Your Best Healthcare”. Sipas përmbajtjes së këtij dokumenti, prodhuesi autorizon shprehimisht subjektin “BORA GROUP ALBANIA” sh.p.k. për paraqitjen e ofertës, si dhe për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës me autoritetin kontraktor, për objektin e prokurimit që përfshin mallrat e prodhuara prej tij.

Ky autorizim vërtetohet në mënyrë të qartë dhe të padiskutueshme se operatori ekonomik është i njohur dhe i miratuar nga prodhuesi për furnizimin e produkteve përkatëse, duke garantuar autenticitetin e pajisjeve, përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të deklaruara në katalogë, si dhe burimin e ligjshëm të mallrave të ofertuar.

Në këtë kuptim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë, e dokumentuar dhe e argumentuar ndërmjet produkteve të kontestuara, katalogëve teknikë të prodhuesit dhe autorizimit përkatës të lëshuar prej tij, çka dëshmon përmbushjen e plotë të specifikimeve teknike dhe kriterit kualifikues përcaktuar në kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

II.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “KONEX” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “BORA GROUP ALBANIA” shpk me arsyen se: *nuk plotëson specifikimet teknike*, KSHA arsyeton se:

Në Nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

1. *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

5. *Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane

Në nenin 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar:

"Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike".

Në Shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar se:

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

➤ SPECIFIKIMET TEKNIKE LOTI 9

IX.Grafi DR

Gjeneratori

- Gjenerator me frekuence te larte
- Linja 3 faze 400/480VAC
- Fuqia e daljes se gjeneratorit: Te pakten 50kë
- Intervali I voltazhit te tubit: 40-150kV
- Koha minimale e ekspozimit: ≤ 1 msek.
- Koha maksimale e ekspozimit: ≥ 10 sek.
- Intervali I rrymes: $\geq 10-630$ mA
- Intervali I rrymes dhe kohes: Vlera minimale ≤ 0.4 mA ; Vlera maksimale ≤ 1000 mA

- Program me anatomi te integruar ne menune e zgjedhjes se projekteve te sistemit per marrjen e imazheve DR
- Sinkronizim I parametrave te programit anatomic me gjeneratorin
- Vet diagnostikim I gjeneratorit me mesazhe gabimi ne raste defekti
- Kontroll automatic I ekspozimit(AEC)"

Tubi I Rrezeve X

- Materiali i anodes:Rhenium-Tungsten,Molybden
- Numri i focal spot ne tubin e rrezeve X: Jo me pak se dy
- Diametri i focal spot:0.6mm-1.2mm
- Kapaciteti termik I anodes:Jo me pak se 230 kHU
- Fuqia e fokusit te vogel: $\geq 22\text{kE}$
- Fuqia e fokusit te madh: $\geq 50\text{kE}$
- Shpejtesia e rrotullimit te anodes @60Hz: $\geq 3200\text{rpm}$
- Matja e dozës se rezatimit(DAP-meter) dhe paraqitja e vlerave te matura ne konsolen e operatorit"

Kolimatori

- Kolimator manual
- Ndricimi I fushes se ekspozimit me drite tip LED
- Indikator me rreze lazer per centrim
- Fushepamja maksimale @SID100 cm: $\geq 43\text{cm} \times 43\text{cm}$ "

Kolona e tubit

- Kolona e tubit e montuar ne dysHEME
- Intervali i levizjes se kolones se tubit ne drejtimin gjatesore(longitudinal): $\geq 180\text{cm}$
- Mundesi levizje e tubit ne drejtimin vertical
- Rrotullimi i tubit te rrezeve X rreth aksit horizontal: $\geq 135^\circ$
- Rrotullimi i kolones rreth aksit vertical: $\geq 180^\circ$
- Funksion automatic i centrimit te poterit me tubin
- Ndjekje automatike e tubit per te ndjekur levizjen vertikale te detektorit ne stativin vertical."

Shtrati I grafise

- Gjatesia e tavolines: $\geq 2000\text{mm}$
- Gjerësia e tavolines: $\geq 800\text{mm}$
- Intervali I levizjes se tavolines ne drejtimin gjatesore(longitudinal): $\geq \pm 450\text{mm}$
- Intervali I levizjes se tavolines ne drejtimin trasveral(lateral): $\geq 120\text{mm}$
- Peshë mbajtëse e tavolines: $\geq 230\text{Kg}$
- Mundesi e nderrimit te grides nga operatori
- Karikues i integruar i detektorit ne poter
- Ndjekja e levizjes horizontale te tubit nga detektori ne tavoline
- Kontroll automatic i ekspozimit,minimum tre fusha(AEC)"

Stativi Vertikal

- *Diapazoni i levizjes vertikale: ≥ 150 cm*
- *Lartesia minimale e qendres se poterit nga toka: ≥ 300 mm*
- *Lartesia maksimale e qendres se poterit nga toka: ≥ 1800 mm*
- *Menyra e levizjes vertikale: Manuale ose e motorizuar*
- *Grida e zevendesueshme nga operatori*
- *Ndjekje e ndryshimit te pozicionit te detektorit nga tubi i rrezeve X*
- *Detektor i integruar per stativin vertical*
- *Karikues i integruar i detektorit ne poter"*

Detektor Dixhital Flat Panel ËiFi I levizshem

- *Detektor dixhital me ëireless flat-panel per ekzaminim ne poter dhe jashte*
- *Madhesia e detektorit aktiv 43×43 cm ± 1 cm*
- *Resolucioni i detektorit i shprehur ne numrin e pikselave > 9 milion*
- *Madhesia e pikselit $\leq 139 \mu\text{m}$*
- *Thellesia e akuizicionit ≥ 16 bit*
- *Resolucioni linear i detektorit ≥ 3.6 lp/mm*
- *Pesha e detektorit ≤ 4.6 kg*
- *Mundesi e perdorimit te detektorit jashte poterit per pacientet*
- *Koha e ardhjes se imazhit ≤ 5 sek*
- *Sasia: 2 detektore"*

Konsole operatore e rrezeve X

- *Sistem i integruar ne nje console per kontrollin e gjeneratorit te rrezeve X dhe sistemit te imazheve dixhitale*
- *Monitor LCD me ngjyra, resolution minimal 1920×1080 dhe madhesi ≥ 23 "*
- *Parametrat kompjuterike minimum 16 GB Ram, HDD minimum 1 TB*
- *Mundesi e futjes se te dhenave te pacientit permes tastieres*
- *Periresim i bordurave dhe reduktim i zhurmave*
- *Pershtatja e drites se imazhit, ndricimit, kontrastit*
- *Rrotullim i imazhit ne cdo kend*
- *Matje e gjatesise dhe kendit*
- *Menaxhim i listes se pacienteve*
- *Funksion i shtimit te teksit ne imazh*
- *Konsole me programe anatomie te integruar per marrjen e imazheve DR"*

Printer

- *Printer per printimin e imazheve ne film*
- *Te suportojte te pakten formatet e filmave: $14" \times 17"$; $10" \times 12"$; $8" \times 10"$*
- *Sasia 1 cope"*
- *Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i vecantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.*

Në përmbushje të kërkesës së sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim katalogun përkatës të paraqitur nga operatori ekonomik "BORA GROUP ALBANIA" shpk ku rezulton përmbushja e specifikimeve teknike për artikujt e pretenduar nga operatori ekonomik ankimues. Nga analiza e katalogut të paraqitur rezulton se artikujt e ofruar nga operatori ekonomik i sipërcituar, plotësojnë kërkesat teknike minimale dhe funksionale të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Specifikimet teknike të pasqyruara në katalog, përfshirë karakteristikat teknologjike, parametrat funksionalë, materialet përbërëse, standardet e sigurisë dhe mënyrën e përdorimit, duke qenë në përputhje me kërkesat e parashikuara në Shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se katalogu i paraqitur përmban informacion të qartë, të plotë dhe të verifikueshëm, i cili mundëson identifikimin e saktë të artikujve të ofruar dhe krahasimin e tyre me specifikimet teknike të kërkuara. Për secilin artikull janë pasqyruar të dhëna që dëshmojnë përmbushjen e parametrave teknikë thelbësorë, duke garantuar funksionalitetin, cilësinë dhe sigurinë e pajisjeve apo produkteve të ofruara.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i katalogut rezulton se produktet e ofruara janë në përputhje me standardet përkatëse kombëtare dhe evropiane të aplikueshme për pajisjet mjekësore, përfshirë kërkesat për cilësi, performancë dhe siguri. Kjo përputhshmëri dëshmon se operatori ekonomik i shpallur fitues paraprak, zotëron kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për materialet kite dhe prokurimin publik.

Në këtë kuadër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson se qëllimi i kërkesës për paraqitjen e katalogeve nuk është vetëm dorëzimi formal i një dokumenti, por siguri i provave konkrete se artikujt e ofruar i përgjigjen nevojave reale të autoritetit kontraktor. Nga analiza e bërë, ky qëllim është përmbushur nga operatori ekonomik "BORA GROUP ALBANIA" shpk, pasi katalogu i paraqitur ofron informacion të mjaftueshëm dhe bindës për përputhshmërinë teknike të produkteve të ofruara.

Paralelisht me shqyrtimin e katalogut, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave analizoi edhe autorizimet e prodhuesve të paraqitura nga operatori ekonomik, të cilat dëshmojnë se "KRIJON" shpk është i autorizuar ligjërisht për tregtimin, furnizimin dhe shpërndarjen e produkteve të ofruara, në kuadër të kësaj procedure prokurimi. Këto autorizime konfirmojnë marrëdhënien zyrtare midis operatorit ekonomik dhe prodhuesve përkatës, si dhe garantojnë origjinalitetin, cilësinë dhe mbështetjen teknike të produkteve të ofruara.

Komisioni vlerëson se ekzistenca e autorizimeve të prodhuesve është një element thelbësor në vlerësimin e përmbushjes së kërkesave teknike dhe ligjore, pasi ato sigurojnë se produktet e ofruara janë të prodhuara nga subjekte të licencuara dhe të certifikuara, janë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane për pajisjet mjekësore, shoqërohen me garanci, shërbim pas-shitjes dhe asistencë teknike të autorizuar, si dhe mundësojnë gjurmueshmërinë dhe sigurinë e përdorimit të tyre.

Në këtë kontekst, autorizimet e prodhuesve, në kombinim me katalogët përkatës, përbëjnë prova të mjaftueshme dhe bindëse se operatori ekonomik "BORA GROUP ALBANIA" shpk zotëron kapacitetin teknik dhe profesional për të realizuar kontratën objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe kuadrin ligjor në fuqi për pajisjet mjekësore.

Gjithashtu, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se vlerësimi i dokumentacionit teknik dhe i autorizimeve të prodhuesve nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është realizuar në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë. Në këtë drejtim, dokumentacioni i paraqitur nga “BORA GROUP ALBANIA” shpk në kuadër të përmbushjes së specifikimeve teknike, nuk paraqet mangësi substanciale ose thelbësore që do të cenonin përmbushjen e kontratës, por përkundrazi, garanton realizimin e saj në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Pra, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pas shqyrtimit të plotë të katalogut përkatës dhe autorizimeve të prodhuesve, gjykon se operatori ekonomik “BORA GROUP ALBANIA” shpk ka përmbushur si kërkesat teknike ashtu edhe ato ligjore të përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke e konsideruar të drejtë vlerësimin e kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “KONEX” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.9. Informacionin për shqyrtimin e ankesës autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr, 294/4 prot., datë 12.02.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Konex” SHPK për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK të specifikimeve teknike të parashtruara në

ankesë si dhe për pretendimin “Gjithashtu ankimuesi “Konex” SHPK pretendon që pajisja Grafi Dr me të cilën shoqëria “Bora Group Albania” SHPK operon, ka vlerë më të ulët sesa pajisja Grafi Dr që përmbush specifikimet teknike të kërkuara në DST.”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, për këto pretendime, operatori ekonomik ankimues, nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike objekt ankimi si dhe pretendimet mbi vlerën e pajisjes Grafi Dr.

III.1.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.1.2. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK të specifikimeve teknike objekt ankimi si dhe pretendimet mbi vlerën e pajisjes Grafi Dr, ankimuesi “Konex” SHPK duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin, etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë, në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime *a-priori* duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.1.6. Një pretendim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar para tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik është parë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e saj, KPP zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një pretendim, i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Konex” SHPK, për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK të specifikimeve teknike objekt ankimi si dhe pretendimet mbi vlerën e pajisjes Grafi Dr, nuk merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Konex” SHPK se: “[...] nga të dhënat që kemi në lidhje me shoqërinë “Bora Group Albania” Sh.p.k. dhe produkti që ka ofertuar nuk plotëson Kërkesa e Veçanta për Kualifikim sipas pikës 6 Seksioni 2.3 Kapaciteti Teknik pasi për njësitë përbërëse të Grafi DR dhe konkretisht :

-Nuk disponon Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për Tubi i rrezeve X si dhe pjesën përbërëse të tubit Matja e dozes se rezatimit(DAP-meter) i cili nuk prodhohet nga kompania ofertuar

-Nuk disponon Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për Dedektori, Detektor Dixhital Flat Panel ëiFi I levizeshme,

-Nuk disponon Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për pjesën përbërëse të Shtrati I grafise konkretisht paisjen Gridës së ndërrueshme si dhe për paisjen qe ben Kontroll automatic i ekspozimit,minimum tre fusha(AEC)” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të tenderit, loti 9, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “2.3 kapaciteti teknik”, pika 6 dhe 7, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

6.Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin /distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

7.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike për artikullin objekt prokurimi loti 1, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit. Nëse katalogu/ët /skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

III.2.2. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK ka ngarkuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

 6_Autorizim_dist_Bora
 6_Autorizim_Fuji_per_Fuji_Turqi
 6_Comprehensive_Authorization_Letter_original
 6_FUJIFILM_MAF_for_Medical_Distribution_Original_original
 6_MAF_Fuji_dhe_DRGEM
 6_Manufacturer's_statement_DRGEM_Original
 7_Brochura_DRGEM_E_perkthyer
 7_Brochura_origjinale_Grafi_e_Markuar_DRGEM
 7_Kataloget_DR_GEM_dhe_Fuji_te_Perkthyer
 7_Katalogu_i_detektorit_i_Markuar
 7_Katalogu_i_Grafise_i_markuar
 7_Katalogu_i_Printerit_i_Markuar_Fuji
 7_Katalogu_i_Tubit_i_Markuar

III.2.3. Në nenin 77, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, parrënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.4. Referuar frymës së legjislationit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit

me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.5. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin *2.3.6.Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin /distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

Referuar kriterit të sipërpërmendur konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë se operatorët ekonomikë ofertues për artikujt objekt prokuirmi duhet të paraqesin autorizim/marrëveshje me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, ku të provohet lidhja mes prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi. Në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, KPP konstaton se, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Duke u nisur nga pretendimi i ankimesit dhe në ballafaqim me dokumentacionin e ngarkuar në sistem për përmbushjen e kriterit më sipër, KPP konstaton se për pajisjet objekt ankimi operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK ka paraqitur të shoqëruar me vërtetim njësie me origjinalin dhe vërtetim përkthimi nr. Rep 10420 datë 08.12.2025 autorizim nga prodhuesi DRGEM Corporation me specifika të numrit të referencës, objektit të procedurës dhe autoriteti kontraktor që lidhen me procedurën e prokurimit objekt ankimi duke deklaruar konkretisht në përmbajtje se: *“Ne, DRGEM Corporation, me zyrën qendrore në 7F, E-Building, Gwangmyeong Techno Park, 60 Haan-ro, Gwangmyeong-si, Gyeonggi-do, Koreja e Jugut (14322) dhe si prodhues i Sistemit Diagnostik Digital me Rreze X GXR-SD, autorizojmë: Bora Group Albania SHPK Rr. Babë Rexha, pallatet EdilAl Dyqani nr.1 1001, Tirane, Shqiperi, për të paraqitur një ofertë dhe më pas për të negociuar dhe nënshkruar një kontratë em uu me objekt prokuirmi; “Furnizimi dhe Instalimi i Pajisjeve Mjeksëore për nevojat e Spitalit Rajonal Shkodër” i ndarë në 9 (nëntë) lot-e për mallrat e prodhuara nga ne. Ky*

autorizim është gjithashtu i vlefshëm regjistrimin e produkteve tona sipas kërkesave të rregullores shqiptare për pajisjet mjeksore.” Akoma më tej, KPP vëren se operatori ekonomik “Bora Group Albania” SHPK për pajisjet objekt ankimi ka ngarkuar në sistem katalogjet/broshurat e prodhuesit *DRGEM Your Best Health Care* të cilat jo vetëm vërtetojnë prezencën fizike të tyre por edhe lidhjen mes prodhuesit dhe dokumentetit kyç që verifikon përputhshmërinë e specifikimeve teknike të premtuara në ofertë me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor sic janë katalogjet/broshurat në rastin konkret. Në këtë kuadër KPP vëren se egziston një lidhje e qartë në dokumentacion dhe përmbajtje mes autorizimit të prodhuesit dhe katalogjeve/broshurave të paraqitura për artikujt objekt ankimi duke dëshmuar përmbushjen e kërkesave të autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Sa më sipër me dokumentacionin e paraqitur për pajisjet objekt ankimi nga ana e operatorit ekonomik “Bora Group Albania” SHPK rezulton se është përmbushur kriteri i vecantë i kualifikimit i përcaktuar në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik pasi verifikohet jo vetëm prezenca e katalogjeve/broshurave dhe autorizimit të prodhuesit por edhe lidhja e qartë mes prodhuesit *DRGEM Your Best Health Care* dhe katalogjeve/broshurave të lëshuara po nga ky prodhues për artikujt objekt ankimi.

Sa më lart pretendimi i ankimuesit “Konex” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Konex” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-68523-11-12-2025, me objekt: “Loti 9 “Furnizim vendosje Grafi DR”, me fond limit 7,033,333.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Konex” SHPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

